

Në bazë të nenit 52 të Ligjit për planifikimin e hapësirës dhe ndërtimin e objekteve ("Fl. zyr. MZ", nr. 064'57, 44/18 dhe 63/18), nenit 34, paragrafi 1 dhe 3 dhe nenit 40, paragrafi 2, pika 3 të Ligjit për pronën shtetëzrasi ("Fl. zyr. MZ", nr. 21/09 dhe 40/11), nenit 28 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për marrëdhëniet pronfisore juridikare ("Fl. zyr. MZ", nr. 19/09), nenit 33 paragrafi 1 pika 1 dhe nenit 38 paragrafi 1 pika 9 të Ligjit për veteqeverisur. lokale ("Fl. zyr. MZ", nr. 2/18) dhe nenit 36, paragrafi 2 dhe 3 dhe nenit 42, paragrafi 1 pika 9 të Statutit të Komunes së Ulqinit ("Fl. zyr. MZ - dispozitat e komunes", nr. 5/07, 9/09 dhe 16/11), Kuvendi i Komunes së Ulqinit **ne** mbledhjen e mbajtur, më 25.03.2019 ka nxjerre

V E N D I M I N

për blerjen e tokës me qëllim kompletimit të parces urbanistike nr. 226 në zonën A nga NP PDU "Ulqini - Qyteti" për lokalitetin "Totoshi" Komuna e Ulqinit

Neni 1

I lejohet Dragović Bajramit blerja e parces kadastrale nr. 5556/3 me kulture toke jopjellore, me sipërfaqe prej 19,00 m² e regjistruar në FP nr. 604 KK Ulqin, si prone e Malit të Zi - bartes i të drejtës së disponimit Komuna e Ulqinit, me qëllim të kompletimit të parces urbanistike nr. 226 në zonën A, e formuar me Ndryshimet dhe plotësimet e PDU "Ulqini - Qyteti" për lokalitetin "Totoshi".

Neni 2

Parcela urbanistike e përmendur në nenin 1 të këtij Vendimi përbehet prej parcelave kadastrale e cila është subjekt i blerjes dhe një pjesë e parces kadastrale nr. 5517, nga FP nr. 4441 KK Ulqin - pronesi e Dragović Isa Bajramit me sipërfaqe prej 547 m².

Neni 3

Patundshmeria nga neni 1 i këtij Vendimi blehet me kompensim në shumën prej 200,00 € për 1 m², që në total është 3.800,00 €.

Kompensimi në shumën e përmendur është caktuar nga ana e organit të autorizuar shtetëror, Drejtorisë për patundshmeri të Malit të Zi, Njësia rajonale Ulqin - Komisioni për vlerësimin e vlerësimit të patundshmerive në territorin e Komunes së Ulqinit.

Neni 4

Autorizohet Kryetari i Komunes së Ulqinit që me Dragović Bajramin të lidhë kontratë për shitblerjen e patundshmerisë nga neni 1 i këtij Vendimi, me të cilën do të rregullohen të gjitha të drejtat dhe obligimet e paleve kontraktuese.

Neni 5

Personi nga neni 1 i këtij Vendimi e fiton të drejtën e regjistrimit të drejtës së pronësive në patundshmeri tek Drejtoria për patundshmeri të Malit të Zi - Njësia rajonale Ulqin, pas shlyerjes së obligimit të kontraktuar.

Nëse personi nga paragrafi 1 i këtij neni në afat prej 30 (trideset) ditësh nuk e lidhë kontratën nga neni 4 i këtij Vendimi dhe nuk i shlyen detyrimet ky Vendim pushon së qeni i vlefshëm.

Neni 6

Tatimin në qarkullim të patundshmerisë e paguan blerësi.

Neni 7

Ky Vendim hyjë në fuqi ditën e tërë pas botimit në Fletoren zyrtare të Malit të Zi — dispozitat e komunes.

Numer: 02-60/19-9
Ulqin, më 25.03.2019

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT
Kryetari
Dr. Ilir Çapuni, d.v.